

**Prezantimi i Komisionerit, z. Besnik Dervishi,  
në Konferencën e 2-të Kombëtare  
“Për të Drejtën e Informimit/pyetshtetin.al”**

Më lejoni që të falenderoj për mbështetjen dhe pjesëmarrjen e veçantë në këtë aktivitet  
znj. Valentina Leskaj, Nënkrjetar i Kuvendit të Shqipërisë,  
znj. Milena Harito, Ministër Shteti për Inovacionin dhe Administratën Publike,  
znj. Dewi van de Weerd, Ambasador i Mbretërisë së Hollandës në Shqipëri,  
znj. Rosemary Agnew, Komisioner i Skocisë për të Drejtën e Informimit,  
znj. Anamarija Musa, Komisioner i Kroacisë për të Drejtën e Informimit,  
dhe z. Andi Dobrush, Drejtor Ekzekutiv i Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – Soros,  
bashkëudhëtar i këtij rrugëtimi që kemi nisur së bashku për zbatimin e të drejtës për informim.

Zonja dhe zotërinj.

Ligji i ri “Për të drejtën e informimit” konsiderohet, nëse përdorim një term në anglisht, “sunshine law”. Pra, është një ligj që ndriçon të gjitha skutat e errta të administratës publike, apo të Autoriteteve Publike, siç konsiderohen në kuptim të këtij ligji. Ato duhet të jenë sa më transparente, për të luftuar drejtpërdrejtë korrupsionin. Ky ligj ndryshon mentalitetin e zyrtarëve dhe mënyrën e qeverisjes, gjithashtu, rrit nivelin e llogaridhënies së Autoriteteve Publike dhe ajo që është më e rëndësishmja, rrit pjesëmarrjen qytetare. Me zbatimin e këtij ligji, ne përmbushim parimin e rëndësishëm të qeverisjes së mirë, me shtyllat e saj: transparencën, përgjegjshmërinë dhe pjesëmarrjen.

### **QEVERISJA E MIRË**

Transparenca siguron aksesin në informacionin publik, garancinë e një drejtësie administrative dhe një vendimmarrje të argumentuar. Nuk mjaftojnë vetëm dy elementët e parë, por, çdo Autoritet Publik në veprimtarinë e tij, që e përmbyll me një vendimmarrje, duhet që në çdo rast ta argumentojë atë. Ne, të gjithë këtu, jemi përfaqësues të administratës publike, të institucioneve të qeverisjes qendrore apo vendore, të institucioneve të pavarura, apo nga ato të sistemit të drejtësisë, por jo të gjitha këto institucione i plotësojnë elementët e domosdoshëm për të qënë një administratë transparente.

### **ADMINISTRATË TRANSPARENTE**

Administrata transparente karakterizohet nga bërja publike e shërbimeve që ofron, nga veprimtaria dhe vendimarrja e saj nëpërmjet transparencës së akteve, të cilët nuk duhet thjesht të nënshkruhen e të harrohen në sirtarë. Gjithashtu, administrat publike duhet të karakterizohet nga procedura të qarta dhe të thjeshta, në çdo hap të veprimtarisë së saj, për të rritur integritetin dhe performancën, jo vetëm të çdo institucioni dhe nëpunësi publik, por, për të parandaluar dhe për të mos lënë asnjë shteg për korrupsion.

## **RISITË E LIGJIT**

Ligji i ri “Për të drejtën e informimit” është miratuar në shtator të vitit 2014 dhe ka hyrë në fuqi në fillim të nëntor të po këtij viti. Në këta 18 muaj, Zyra e Komisionerit i ka prezantuar risitë e tij edhe në takime të tjera, por besoj se është me vend që t’i ritheksojmë shkurtimisht ato edhe sot. Ne e konsiderojmë atë një nga ligjet më të rëndësishme, pasi ai mbron të drejtën për informim që ka çdo individ, pa qënë e nevojshme të sqarojë motivet. Autoriteti Publik është i detyruar ta japë informacionin pa kërkuar motivet dhe kjo është vetëm njëra anë, sepse, ana tjetër, janë Programet e Transparencës, ose tërësia e informacionit publik që jepet pa kërkesë. Një tjetër risi themelore e ligjit është edhe emërimi dhe roli i koordinаторit për të drejtën e informimit. Në këtë dokument, gjithashtu, parashikohen hapat dhe kompetencat për shqyrtimin e ankesave, rastet e kufizimit të të drejtës për informim, si edhe rastet e shkeljeve dhe sanksioneve administrative.

## **ANALIZA E ZBATIMIT TË LIGJIT**

Një nga aspektet më të rëndësishme të punës së Zyrës së Komisionerit, është ai i trajtimit të ankesave të qytetarëve. Gjatë vitit të kaluar janë regjistruar 274 të tilla, ndërsa vetëm për 4 muajt e parë të 2016 janë paraqitur 177 ankesa. Më lejoni të theksoj, se një nga veçoritë e këtij procesi është se për vitin 2015, 199 ankesa janë zgjidhur me ndërmjetësim. Ndërsa, për këta 4 muaj të 2016, 150 të tilla u zgjidhën po në këtë mënyrë. Kjo do të thotë, se këtij numri shumë të lartë ankesash i është dhënë zgjidhje, pra qytetarët kanë marrë informacionin e kërkuar, menjëherë pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit. Shpesh herë, Autoritetet Publike ndoshta neglizhojnë dhënien e përgjigjes, ose kanë mungesë kompetence në dhënien e informacionit. Dhe kjo është një sfidë, ku puna e këtyre institucioneve duhet të përmirësohet, pasi nuk është e nevojshme ndërhyrja e Zyrës së Komisionerit për t’iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve.

Sigurisht, që numri më i lartë i ankesave pranë Zyrës së Komisionerit është regjistruar nga qarku i Tiranës, duke qënë se këtu ndodhen shumica e Autoritetev Publike të vendit, institucione qendrore dhe ato të pavarura. Por, duke krahasuar shifrat e viteve 2015/2016, vërehet një tendencë në rritje e numrit të ankesave edhe nga zona të tjera të vendit. Kjo tregon, nga njëra anë, njohjen e gjithnjë e më të madhe të ligjit dhe të kësaj të drejte kushtetuese, si edhe garancinë që i është dhënë qytetarëve, e nga ana tjetër, të drejtën e tyre për ta shfrytëzuar këtë nëpërmjet ankesës pranë Zyrës së Komisionerit.

Nga analiza e deritanishme e zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” konstatojmë një situatë jo shumë të favorshme përsa i përket informacionit pa kërkesë, pra hartimit të Programit të Transparencës nga Autoritetet Publike. Kjo është një detyre ekskluzive e të gjithë këtyre institucioneve. Sipas dispozitave ligjore, data 4 maj 2015, ishte afati i fundit kur të gjitha Autoritetet Publike duhet të kishin përgatitur dhe publikuar Programet e Transparencës. Duhet thënë se jo të gjitha Autoritet e kanë përmbushur këtë detyrim, shumë prej tyre kanë plotësuar vetëm disa elementë të programit të transparencës.

Aktualisht, janë 125 institucione që kanë Program Transparence dhe natyrisht, edhe këtu kemi rezerva, sepse këto Programe nuk janë në nivelin e kërkuar. Por, ne e konsiderojmë situatën pozitive, pasi këto insitucione e kanë thyer mentalitetin e vjetër që ekzistonte në Autoritetet tona Publike. Gjithashtu, janë caktuar 226 koordinatore për të drejtën e informimit nga këto Autoritete. Nga ana tjetër, Zyra e Komisionerit ka kryer 124 inspektime në terren dhe ka dalë gjatë kësaj periudhe 18-mujore me 53 vendime.

## **NDËRGJEGJËSIMI QYTETAR**

Paralelisht, vëmendja jonë është fokusuar edhe te procesi i ndërgjegjësimit të opinionin publik, duke zhvilluar një fushatë të gjerë, në rradhë të parë me Autoritetet Publike, sepse janë këto institucione që duhet të përmbushin detyrimet e këtij ligji. Gjatë kësaj periudhe, Zyra e Komisionerit ka zhvilluar disa trajnime me koordinatorët e institucioneve qendrore dhe vendore. Jemi në fazën e zhvillimit të takimeve në çdo qark të vendit, ku deri tani kemi zhvilluar trajnime në 4 qarqe dhe brenda këtij vitit, do të zhvillojmë takime edhe në 8 qarqet e tjera. Në këto aktivitete kemi trajnuar titullarët dhe koordinatorët e pushtetit vendor, si dhe drejtuesit e institucioneve qendrore në nivel vendor.

Rast pas rasti, për çdo ankesë kemi kontaktuar me përfaqësuesit e Autoriteteve Publike, njëkohësisht, duke u dhënë atyre asistencën e nevojshme për zbatimin rigoroz të ligjit. Fushata jonë sensibilizuese është përqëndruar edhe tek qytetarët, që nga transmetimi në media i spoteve publicitare, apo në shpërndarjen e materialeve ndërgjegjësuese për të drejtën e informimit, ndërsa kemi zhvilluar edhe trajnime me studentët e gazetarisë në universitetet e Tiranës dhe të Elbasanit, në bashkëpunim me Qendrën e Informimit të Bashkimit Evropian në kryeqytet.

## **PROJEKTET NDËRKOMBËTARE**

Zyra e Komisionerit, po ashtu, nuk ka lënë pas dore edhe përfitimin e projekteve me partnerët ndërkombëtarë. Kjo Konferencë është rast sinjifikativ, pasi organizimi i saj është bërë në bashkëpunim të ngushtë me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë – Soros. Ky Fondacion ka qënë përkrahësi dhe mbështetësi kryesor i Zyrës së Komisionerit gjatë këtyre 18 muajve, që prej hyrjes në fuqi të ligjit të ri. Kemi një projekt të suksesshëm së bashku dhe mendoj se ky bashkëpunim do të shtrihet edhe përgjatë disa viteve të tjera. Gjithashtu, po zbatojmë një projekt me SIGMA/OECD për asistencë teknike për Zyrën e Komisionerit. Ndërsa, jemi të përfshirë në projektin e binjakëzimit “Mbështetje për formulimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave anti-korrupsion” dhe në projektin për financimin buxhetor nga BE për “Strategjinë ndërsektoriale për reformën në administratën publike”.

## **TRANSPARENCA DHE ROLI I ZYRËS SË KOMISIONERIT**

E përmenda edhe më sipër, Zyra e Komisionerit ka konstatuar një mungesë të madhe të transparencës nga Autoritetet Publike. Në rradhë të parë, është neglizhenca në dhënien e informacionit. Ligji parashikon një afat kohor, një procedurë dhe disa sanksione, për koordinatorin në rradhë të parë, për titullarin e institucionit dhe për çdo nëpunës që bëhet pengesë në dhënien e tij, apo në fshehjen e informacionit. Kjo praktikë duhet evituar nga Autoritetet Publike.

Ka raste të mosdhënies së informacionit për mungesë të aftësisë profesionale dhe shpesh herë, ne konstatojmë që nëpunësit nuk e njohin ligjin. Ky ligj është i ndërthurur edhe me disa ligje të tjera që kanë të bëjnë me kufizimet e dhënies së informacionit, si ligji për sekretin tregtar, ai për mbrojtjen e të dhënave personale, etj. Koordinatorin në rradhë të parë, por edhe të gjithë nëpunësit e tjerë të Autoritetit Publik, duhet të vihen në dispozicion të kërkesës dhe të plotësojnë të gjithë procedurën që parashikon ligji.

Në disa raste kemi konstatuar, me keqardhje duhet ta them, se ende ka mbetje të mentalitetit të vjetër të mosdhënies së informacionit, apo mungon dëshira për të plotësuar detyrimet që rrjedhin

nga ky ligj, çka përbën në të dyja rastet shkelje të rëndë të të drejtës së informimit. Në këtë kontekst, duhet përmendur edhe roli ndërmjetësues i Zyrës së Komisionerit, ku e theksova edhe më parë, se Autoritetet Publike vihen në lëvizje vetëm pas ndërhyrjes sonë. Natyrisht, ne e konsiderojmë këtë vlerësim për rolin dhe punën e institucionit tonë.

## **PROCESI I TRANSPARENCËS**

Në konceptin e gjerë të transparencës, ne kemi përcaktuar disa hapa, që nga trajtimi i ankesës; procedura që ndjekim, duke respektuar afatin 15 ditë pune që parashikon ligji; vlerësojmë rezultatin, që për ne është e rëndësishme, pra, bërja e transparencës. Por, ne kemi përcaktuar edhe ndikimin (impaktin) pozitiv të të gjithë këtij procesi, që janë sensibilizimi, ndërmjetësimi dhe vendimmarrja. Të gjithë këta elementë ne i analizojmë periodikisht në punën tonë të përditshme.

## **VLERËSIMET NDËRKOMBËTARE**

Sigurisht, që në aktivitetin tonë kemi patur edhe mangësi, por, na vjen mirë të konstatojmë që nga partnerët tanë kryesorë kemi patur vlerësime. Vlen të cilësohet në rradhë të parë, vlerësimi i Delegacionit të Bashkimit Evropian në raportin e Grupit të posaçëm për Rreformën në Administratën Publike. Është shprehur vlerësimi më i lartë për zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”. Për stafin e Zyrës së Komisionerit dhe veçanërisht, për Drejtorinë për të Drejtën e Informimit, përveç vlerësimit, është, njëkohësisht, edhe angazhim për të përsosur akoma më shumë punë e bërë deri tani.

Gjithashtu, vlerësim për aktivitetin tonë kanë dhënë një sërë organizatash jo fitimprurëse, të cilat duhet thënë, se kanë qënë tejet aktive dhe pa pjesëmarrjen e tyre, zbatimi i këtij ligji ndoshta nuk do të ishte në këtë nivel që është sot. Sipas tyre, Komisioneri ka përmbushur detyrimet ligjore në gjykimin e ankesave të regjistruara.

Dua të theksoj në këtë takim, se shumë i rëndësishëm është ndikimi i drejtpërdrejtë që ka patur zbatimi i këtij ligji për qytetarët. Më lejoni të përmend një rast sinjifikativ, ku një qytetar është shprehur se “kam që në vitin 1996 që e kërkoj një dokument dhe nuk kam arritur ta siguroj, sot ja arrita kësaj dite”. Edhe pse ky rast mund të jetë shumë i rrallë dhe i shkëputur, gjithsesi, tregon se kemi ende probleme të tilla.

## **AMENDIMET LIGJORE**

Përmenda në fillim që ligji është një ligj i mirë, por natyrisht, kjo nuk do të thotë se nuk duhet të përmirësohet. Ndoshta është ende herët, sepse ka vetëm një vit e gjysëm që ai zbatohet, por kemi konstatuar disa problematika që duhet të ishin programuar më mire. Njëra prej tyre është që ashtu siç ne e krahasojmë me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, akti i Komisionerit duhet të konsiderohet “titull ekzekutiv”. Ky ndryshim duhet marrë në konsideratë, jo për t’i ardhur në ndihmë Zyrës së Komisionerit, por, për t’i ardhur në ndihmë qytetarëve, të cilët ankohen tek institucioni ynë. Pra, kur e marrin në dorë vendimin e Komisionerit dhe me mbarimin e afatit të ankimit (në gjykatë), ai të kthehet në “titull ekzekutiv”, që qytetari të mos endet më në dyert e gjykatave.

Mendoj, se ligji ka ndoshta nevojë për ndërhyrje për t’i dhënë atij një dimension të ri dhe për të përcaktuar rregulla më të qarta, pasi në të, aktualisht, nuk parashikohet nxjerrja e akteve

nënligjore. Në këtë pikë, ndoshta puna e Komisionerit kufizohet pak, sepse ligji duhet, që ashtu si edhe ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, t’i japë të drejtën Komisionerit për nxjerrjen e akteve nënligjore. Kemi konstatuar se ka nevojë për ndërhyrje për krijimin e një sistemi vetëvlerësimi për Autoritetet Publike; për hartimin e një udhëzimi për koordinatorët dhe veprimtarinë e tyre, pse jo edhe për statusin e veçantë që ata duhet të kenë në strukturën e institucioneve ku punojnë. E them këtë, sepse ligji e ngarkon koordinatorin me mjaft detyra dhe në fund të fundit, ndoshta, për faj të nëpunësve të tjerë të Autoriteteve Publike, janë koordinatorët ata që penalizohen. Pikërisht për këtë arsye, për t’u vlerësuar dhe për të qënë më të përgjegjshëm në punën e tyre, koordinatorët duhet të kenë një status të veçantë.

Gjithashtu, mendoj se duhet të ndërhyhet në hartimin e një udhëzimi për klasifikimin dhe funksionimin e brendshëm të Autoriteteve Publike. Sepse, siç dihet, ka Autoritete që veprojnë vetëm në qendër – siç është rasti i Zyrës së Komisionerit, por ka edhe Autoritete që kanë edhe degët e tyre të shtrira në të gjithë territorin e vendit dhe kjo kërkon një rregullim. Ky rregullim mund të bëhet edhe nëpërmjet rregulloreve të brendshme të çdo Autoriteti Publik, por ne dëshirojmë që ta unifikojmë këtë praktikë.

### **REZOLUTAT E KUVENDIT TË SHQIPËRISË**

Në fund, por jo për nga rëndësia, nuk mund të lë pa përmendur dhe theksuar mbështetjen e madhe që i është dhënë gjatë kësaj periudhe Zyrës së Komisionerit nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Rezoluta e fundit e miratuar nga ky organ pak ditë më parë, më 21 prill, vlerëson maksimalisht punën e Zyrës së Komisionerit për vitin 2015 dhe njëkohësisht, ka përcaktuar objektiva të qartë që duhet të përmbushë ky institucioni për vitin 2016.

Ju faleminderit.